



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 par 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 13 të Udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë si dhe nenit 20 par. 20.1 dhe 36 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 25.11.2022, pas shqyrtimit të propozimit Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI
GJINORE

Neni 1
Themelimi

Me këtë Vendim, **Themelohet** Komiteti për të drejtat e njeriut dhe barazi i Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Majlinda Sylejmani nga subjekti politik, LDK
2. Venhar Agushi nga subjekti politik, LDK
3. Ftaipe Krasniqi nga subjekti politik, LDK
4. Lumnije Sopa nga subjekti politik, PDK
5. Hasan Luma nga NJDNJ dhe barazi gjinore

Neni 2
Zgjedhja e Kryesuesit

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.

Neni 3
Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore kryen detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

1. Bën monitorimin e punëve dhe aktiviteteve të ndryshme në nivel të komunës nga fusha e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

2.Konsultohet dhe ndihmon Njësitin për të drejtat e Njeriut dhe barazi gjinore të Komunës në hartimin e dokumentacionit, planeve apo strategjive nga fusha e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

5.Komiteti gjatë gjithë punës së tij do ti përmahet dispozitatave të Udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë.

6. Kryen dhe punë të tjera nga fusha e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

Neni 4 Mandati

Mandati i Komitetit për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore është i lidhur me mandatin e anëtarëve të kuvendit të komunës.

Neni 5 Kompensimi

Anëtarët e për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore kompensohen nga buxheti i komunës. Shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

Anëtarët e komiteteve tjera paguhen për gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 020/06-63549
Lipjan, më 25.11.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

**Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi*****

